

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, përmes gjyqtarës së vetme gjykuese Snezhana Mihajllloviq, me sekretaren juridike Suzana Kovaçeviq, në lëndën penale kundër të akuzuarit M.P. nga Gjilani, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378.paragr.6 lidhur me paragr.1 KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.1112/18 të datës 20.08.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më 22.10.2018, në prezencë të palëve publikisht shpalli

A K T G J Y K I M

I pandehuri **M.P.** nga babai A. dhe nëna Sh. - e lindur D., i lindur më dt. ... në fsh. ..., kom. ..., jeton në Gjilan, rr. “ ... ” pn., i arsimuar, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i dy fëmijëve, punon me mëditje, i gjendjes së dobët ekonomike, më parë i pagjykuar, nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

Ë S H T Ë F A J T O R

sepse më dt. 26.07.2018 rreth orës 01:40 në udhëkryqin që lidh rrugët “Idriz Seferi” dhe “Xhon Sereçi” në Gjilan, i pandehuri M.P. ka rrezikuar trafikun publik duke vë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e markës “Audi” me targa të regjistrimit ..., na pakujdesia dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore nga neni 61 dhe 63 Ligji mbi Rregullat e Trafikut Rrugor, për shkak se nuk e ka respektuar përparësinë e kalimit në rrugë dhe kyçje të pasigurt në rrugë dhe duke bërë kthim majtas, pa u bindur se me veprimin e tillë do të pengoj pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, me pjesën e përparme e godet në rrotën e përparme motoçikletën e markës “BMW CF” të cilën e ngiste N.Sh., i cili ishte duke lëvizur në rrugën me përparësi kalimi, kështu që me lëshimet e të pandehurit, përveç dëmeve materiale, lëndime të lehta trupore pëson i dëmtuari N.Sh., i cili për shkak të lëndimeve detyrohet të kërkoj ndihmë mjekësore në Emergjencën e Spitalit Regjional në Gjilan.

- me çka ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378.paragr.6 lidhur me paragr.1 të KPRK.

Andaj, gjykata, duke u bazuar në dispozitat e neneve 4, 41, 42, 49,50,51,52,73 dhe 74 KPRK-së si dhe nenit 248 KPPRK, të pandehurit i shqipton

DËNIMIN ME KUSHT

I. Dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3(tre)muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej 1(një) viti nuk kryen tjetër veprë penale, në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet.

II. I dëmtuari N.Sh. nga Gjilani, rr. " ... " nr. ..., për realizimin e kërkesës pronësore - juridike është udhëzuar në kontestin civil.

III. I akuzuari obligohet të paguaj paushallin gjyqësor shumë prej 25 € si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan ka ngritë aktakuzë kundër të pandehurit M.P. nga Gjilani, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378. nga neni 378 paragr.6 lidhur me paragr.1 të KPRK.

Gjatë seancës fillestare të mbajtur më dt. 22.10.2018 nga ana e prokurorit të shtetit është bërë leximi i aktakuzës PP.II.nr. 1112/18 të dt. 20.08.2018, dhe pas leximit të aktakuzës i pandehuri deklaroi se në tërësi e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale e cila i vihet në barrë. Në mbrojtjen e tij ka theksuar se pranon se e ka kryer veprën penale, pendohet për këtë, premtonte se në të nuk do të kryej vepra të këtilla apo të ngjashme penale, andaj, lut gjykatën ta më dënoj sa më butë.

Në seancën fillestare publike gjykatësja e vetme gjyqësore mori Aktvendim me të cilin aprovoi pranimin e fajësisë, pasi që konstatoi se për këtë janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore. Gjykatësja e vetme gjyqësore konstatoi se i pandehuri ka kuptuar për natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë: se pranimi është bërë me vet vullnetin e të pandehurit; pranimi i fajësisë është i bazuar në faktet lëndore të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore apo ndonjë gabim faktik.

Gjykata analizoi provat të cilat gjendjen në shkresa të lëndës, ndërsa me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akzuarit, erdhi në përfundim se i akuzuari ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragr.6 lidhur me paragr.1 të KPRK.

Në bazë të nenit 73 dhe 74 KPRK me rastin e shqiptimit të dënimit kundër të pandehurit, gjykatësja e vetme gjyqësore mori parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Si rrethana lehtësuese gjykata për të pandehurin mori parasysh se ka pranuar veprën, është penduar për veprën e kryer, konsideron se ka gabuar, është i gjendjes tejte të dobët ekonomike, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale dhe se më parë nuk ka qenë i gjykuar. Rrethana rënduese nuk ka pasur.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me kusht i shqiptuar kundër të pandehurit është i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe

shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjykata konstatoi se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit nga neni 41 të KPRK që i pandehuri në të ardhmen të mos kryej vepra tjera penale, t'i parandaloj personat tjerë në kryerjen e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, të rris moralin dhe fuqizoj obligimin për t'u respektuar ligji.

Nga të cekurat e mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.706/18 më dt.22.10.2018**

*Sekretarja juridike,
Suzana Kovaçević*

*Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Snezhana Mihajloviq*

UDHËZIMI JURIDIK: *Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në dy kopje dorëzohet përmes kësaj gjykate.*

**Përktheu –
Naile Keçmezi**